



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. "George Bush", Ndërtesa e Rektoratit, Nr. 31, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 1/253  
Data: 2 / 6 / 2025


Senati i Universitetit të Prishtinës, në përputhje me nenin 16, paragrafi 4 dhe nenin 17, paragrafi 3 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, si dhe në bazë të neneve 24 deri 31 të Rregullores me nr. prot. 3/938, datë 30.09.2024, në mbledhjen e mbajtur më 28.05.2025, miraton këtë:

**VENDIM**

1. Shpallen zgjedhjet për përzgjedhjen e pesë (5) anëtarëve të Këshillit Drejtues nga radhët e personelit akademik të Universitetit të Prishtinës. Zgjedhjet për anëtarët e Këshillit Drejtues mbahen në muajin qershor 2025.
2. Procesi zgjedhor për anëtarët e Këshillit Drejtues nga radhët e personelit akademik zhvillohet sipas kalendarit të përcaktuar në shtojcë të këtij vendimi.
3. Komisioni zgjedhor që menaxhon procesin e anëtarëve të Këshillit Drejtues, përbëhet nga tre (3) anëtarë, si në vijim:
  - 3.1. Prof. Asoc. Dr. Majlinda Gjellaj
  - 3.2. Prof. Asst. Kreshnike Dedushi Hoti
  - 3.3. Prof. Asst. Florian Miftari
4. Procedura zgjedhore menaxhohet nga komisioni sipas pikës 3 të këtij vendimi si dhe përfundon me përbërjen e njëjtë të Senatit që ka filluar, bazuar në kriteret e përcaktuara në Statutin e UP-së dhe në Rregulloren me nr. prot. 3/938, datë 30.09.2024.
5. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues bëhet me votim të fshehtë.
6. Vendimi duhet të publikohet në ueb faqen zyrtare të Universiteti, në ueb faqet e njësive akademike dhe në platformat tjera elektronike zyrtare të Universitetit.
7. Mandati i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit Drejtues fillon me 15 shtator 2025 dhe përfundon më 14 shtator 2028.

**Vendimi t'u dërgohet:**

- Anëtarëve të Senatit të UP-së;
- Anëtarëve të Komisionit Zgjedhor;
- U.d. Sekretarit të Përgjithshëm të UP-së;
- Zyrës Ligjore;
- Zyrës për Buxhet dhe Financa në UP;
- Arkivit të UP-së.



**Shtojcë:**

**KALENDARI PËR PROCESIN ZGJEDHOR PËR ANËTARËT E KËSHILLIT  
DREJTUES NGA RADHËT E PERSONELIT AKADEMIK**

<b>Veprimi në kuadër të procesit</b>	<b>Koha/data e mbajtjes</b>
Shpallja e thirrjes për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues nga radhët e personelit akademik	2 qershor 2025  Në thirrjen e shpallur, përcaktohen detajet e dërgimit të dokumentacionit dhe mënyra e aplikimit. Thirrja i dërgohet të gjithë personelit akademik.
Paraqitja e kandidaturave	2 deri 12 qershor 2025
Shqyrtimi i dokumentacionit të kandidatëve nga komisioni zgjedhor dhe verifikimi i përshtatshmërisë së kandidaturave, bazuar në Statut dhe në Rregullores me nr. prot. 3/938, datë 30.09.2024	13 deri 17 qershor 2025
Paraqitja e raportit nga ana e komisionit zgjedhor për Senatin	Më së largu me 23 qershor 2025
Mbledhja zgjedhore e Senatit për shqyrtimin e raportit të komisionit zgjedhor dhe zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues	23 deri 30 qershor 2025
Mbajtja e cikleve të votimit sipas rregullores nr. prot. 3/938, datë 30.09.2024	23 deri 30 qershor 2025
Ankesat e kandidatëve për procesin zgjedhor	1 deri 2 korrik 2025

A. H.